



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 1/2021 regjistër (JD)
Datë 26.02.2021

Nr. 1 i vendimit
Datë 06.05.2021

**VENDIM
PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE**

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Ardian Hajdari	Gjyqtar
Ina Rama	Gjyqtare

- mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi, më datë 06.05.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1/2021, datë 26.02.2021, që i përket:

KËRKUES: Tom Dedaj

SUBJEKTE Këshilli i Lartë i Prokurorisë
TË INTERESUARA: Prokuroria e Përgjithshme
Mbledhja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

OBJEKTI:

1. Deklarimin të paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. 22, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj.
2. Kthimin e paditësit Tom Dedaj në detyrën e mëparshme të prokurorit, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.
3. Dhënia e pagës paditësit Tom Dedaj nga data 28.01.2019 e në vazhdim.
4. Dhënien e një shpërblimi të drejtë paditësit Tom Dedaj në shumën 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë.
5. Konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj.
6. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandateve si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të anëtarëve Gent Ibrahimi, Tartar Bazaj, Bujar Sheshi, Arben Dollapi, Antoneta Sevdari, Besnik Cani, Gentjan Osmani dhe Nurihan Sehitaj.

7. Anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

8. Pezullimin e vazhdimin të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

9. Pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e paditësit Tom Dedaj deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, 15, 16, 17, 18, 23, 30, 32, 33, 42, 43, 44, 49 e vijues dhe 148/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut; nenet 1 dhe 2 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut; neni 1 i Konventës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe të profesionit”; nenet 31, 32, 41, 42, 153, 154, 324, 327, 328, 329, 331 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; nenet 1 e vijues, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 22, 44, 46, 47, 49, 51, 55, 56, 58, 60, 61, 80, 81, 82, 83, 85, 93, 105, 108, 115, 116, 118, 121 e vijues, 125 e vijues të Kodit të Procedurës Administrative; Kodi i Punës, neni 59 i Kodit Penal; neni 462 i Kodit të Procedurës Penale; nenet 1 e vijues, 111, 115 e vijues, 118 e vijues, 157, 160, 161, 164, 166, 169, 172, 173, 174 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 1 e vijues, 26 e vijues, 34 e vijues të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; nenet 276, pika 3 dhe 279, pika 5 e ligjit nr. 115/2015 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; nenet 1, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017 dhe nr. 75, datë 19.04.2002; vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut i datës 22.09.2012, “Rrapo kundër Shqipërisë”; vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 03.01.2014.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tom Dedaj (në vijim “kërkuesi”) ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Më datë 24.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nisur nga një program televiziv i transmetuar më datë 21.10.2016 në televizionin kombëtar Top Channel, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesit për veprën penale të *korruptionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë*, parashikuar nga neni 319/ç

i Kodit Penal. Me urdhrin nr. {***}, datë 31.10.2016, Prokurori i Përgjithshëm vendosi pezullimin e kërkuesit nga ushtrimi i detyrës, deri në përfundim të hetimeve të procedimit penal.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, më datë 26.07.2018, me vendimin nr. {***}, vendosi deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të ngarkuar dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Në zbatim të neneve 30/1, 35, 44/2 të Kodit Penal, gjykata ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës së kërkuesit për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet, ndërsa në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë për një periudhë 5- (pesë) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.
3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, më datë 06.11.2018, me vendimin nr. {***}, ka ndryshuar akuzën për kërkuesin duke vendosur deklarinin fajtor të tij për kryerjen e veprës penale të *moskallëzimit të krimin*, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin me 1 (një) vit burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit vendosi pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien e kërkuesit në provë për një periudhë 2- (dy) vjeçare, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Në aplikim të neneve 30/1, 35/2, 44/2 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës për kërkuesin, për të ushtruar funksione publike për 1 (një) vit.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me dy vendimet e cituara në paragrafët 2 dhe 3 më sipër, dhe me urdhrin e prokurorit Nj. S. për ekzekutimin e vendimit penal të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, mbështetur në nenin 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, me vendimin nr. 22, datë 28.01.2019, vendosi:
 1. *Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. {***}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.*
 2. *Me këtë vendim të njihet Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe z. Tom Dedaj.*
 3. *Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore.*
 4. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*
5. Më datë 26.02.2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit është regjistruar çështja nr. 1/2021 (JD), e vënë në lëvizje nga kërkuesi Tom Dedaj, me palë, objekt dhe bazë ligjore sikurse është pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Pretendimet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

6. Në kërkesën e regjistruar më datë 26.02.2021, kërkuesi parashtron se ka dërguar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit kërkesëpadinë më datë 21.10.2020 dhe se kërkon të fillojë gjykimi i kësaj kërkesë, duke pasqyruar të dhënat e paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Në *kërkesëpadinë* e protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit më datë 21.10.2020, kërkuesi pretendon se vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e tij është i padrejtë, i pabazuar në dokumente dhe prova, i kundërligjshëm, dhënë në mohim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi pretendon:

- Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është dhënë nga një institucion që është ngritur dhe funksionon në mënyrë të kundërligjshme dhe antikushtetuese, i përbërë nga anëtarë që janë shkarkuar nga detyra, që nuk plotësojnë kriteret për t'u zgjedhur e që kanë probleme me ligjin.
- Një pjesë e anëtarëve që kanë votuar për shkarkimin nga detyra të tij gjendeshin në kushtet e konfliktit të interesit me të, për shkak të pozicioneve të punës së tyre të mëparshme dhe situatave të krijuara gjatë shqyrtimit të mëhershëm të çështjeve të tij.
- Anulimin e vendimit të Këshillit të Prokurorisë të datës 19.12.2018 (mbledhja e parë), lidhur me konfirmimin e mandatit të anëtarëve tij, si dhe pezullimin e zbatimit të këtij vendimi deri në përfundimin e gjyqimit të kësaj çështjeje administrative, duke u shprehur për qëndrim sa më të shpejtë për shkak të urgjencës që paraqet kjo masë, duke qenë se ky Këshill vazhdon të funksionojë “në kushte paligjshmërie”.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka pasur kuorimin prej 7 anëtarësh për të shqyrtuar çështjen e tij, pasi 4 anëtarë janë shkarkuar nga detyra, ndërsa 1 anëtar [z. Sheshi] nuk ka marrë pjesë në votim dhe si rezultat, në votim kanë marrë pjesë vetëm 6 anëtarë në detyrë.
- Dëmshpërblim moral, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8737/2001”) dhe në nenin 608 të Kodit Civil, pasi Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë i kanë shkaktuar dëm “të pallogaritshëm” shëndetësor dhe moral.
- Procesi i zhvilluar ndaj tij ka qenë diskriminues në mënyrën e trajtimit, e cila ka qenë e kundërligjshme pasi ai i ka shërbyer sistemit për mbi 20 vjet dhe trajtohet pa dalë para një trupi gjyqësor.
- Vendimi është absolutisht i pavlefshëm si në formë ashtu edhe në përmbajtje, pasi ndër të tjera në vendim mungon paraqitja e faktit dhe mënyra e ankimit, si dhe organi, institucioni apo gjykata ku ankimohet dhe afati kohor i paraqitjes së ankimit.
- Vendimi është marrë në shkëlqje të Kushtetutës, pasi Këshilli i Lartë i Prokurorisë e ka bazuar vendimmarrjen në Kushtetutë, duke marrë atributet e Gjykatës Kushtetuese.
- Në rastin e tij, nuk është aplikuar një proces disiplinor as nga Prokurori i Përgjithshëm dhe as nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ky i fundit nuk ekziston pasi nuk është emëruar ende. Ndërkohë që ai është pezulluar me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, pa një procedim disiplinor, nuk është njohur me ndonjë akt për fillimin e procedurës disiplinore dhe nuk është thirrur për t'u paraqitur dhe dëgjuar përpara Këshillit.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk është një institucion funksional pasi deri në datën që ka dhënë vendimin për kërkuesin, nuk ka pasur as seli, nuk ka ligj dhe një rregullore se si duhet të funksionojë.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 147 të Kodit të Punës dhe me nenin 25 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), pasi në datën 28.01.2019 kur është dhënë vendimi, kërkuesi ka qenë me raport mjekësor, për të cilin ka informuar edhe këtë institucion.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka kompetencë për të shqyrtuar çështjen e tij, pasi ligji nr. 96/2016 vepron për gjyqtarët dhe prokurorët që e kanë kaluar procesin e rivlerësimit.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë është bazuar në një vendim gjyqësor ndaj të cilit është ushtruar rekurs duke anashkaluar dhe injoruar Gjykatën e Lartë dhe nuk qëndron argumenti se [kërkuesi] është dënuar me vendim penal të formës së prerë, referuar vendimit nr. 2/2014 të Gjykatës së Lartë, si dhe qëndrimin të shprehur nga GjEDNj-ja në çështjen Rrapo kundër Shqipërisë.

- Është dënuar me kusht për shkak se nuk paraqet rrezikshmëri dhe është në periudhë prove, ndaj tij nuk ka një masë sigurimi, ndalimi, pezullimi apo dënimi në fuqi, por ka një periudhë prove dhe vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor nuk bën pjesë në kategorinë e veprave për të cilat ai mund të pezullohet nga detyra; nuk e ka pranuar fajësinë, gjykimin e shkurtuar dhe as amnistinë.
 - Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 8737/2001, pasi është dhënë përtej afatit 6-mujor nga data e fillimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës (27.07.2018), bazuar në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale.
 - Ndaj tij nuk është zhvilluar asnjë hetim apo procedim disiplinor dhe urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 01.11.2016, për pezullimin nga detyra është nxjerrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016.
 - Ndodhet në këtë situatë për fajin e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë por edhe të Kolegjit, pasi ndaj tij u përdor një vendim i gjykatës së apelit, ndërkohë që po penalizohet për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë.
 - Të thirren ekspertët për të vlerësuar dëmin moral dhe atë shëndetësor dhe të hartojnë aktet përkatëse të ekspertimit, si dhe të paraqesë në seancë gjyqësore 35 akte¹.
7. Në një fazë më herët, më datë 10.02.2021, në Kolegj është protokolluar kërkesa e z. Dedaj për gjykimin e çështjes në të cilën ai parashtron se pengesë për mosmarrjen në kohë të akteve janë bërë Gjykata Administrative e Apelit dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kërkuesi shprehet se çështja e tij ka nisur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila një pjesë të kërtimeve të tij i kaloi për kompetencë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe një pjesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kjo e fundit, për shkak të mosdakordësisë, e dërgoi çështjen në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë që Kolegji i Posaçëm i Apelit zhvilloi seanca duke marrë një vendim “absurd dhe të kundërligjshëm”, duke e pushuar gjykimin sikur prej tij ishte bërë një kërkesë e tillë, ndërkohë që nuk ishte prezent e nuk kishte

¹ Në faqen 87 të materialit, kërkuesi ka listuar këto akte: 1) shkresa nr. {***} prot., datë 04.02.2019, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për njoftim vendimi; 2) vendimi nr. 22/2019 i KLP-së për shkarkimin nga detyra e prokurorit; 3) shkresa nr. {***} prot., datë 31.10.2016, e Prokurorit të Përgjithshëm për dërgimin e urdhrin të pezullimit; 4) urdhri nr. {***}, datë 31.10.2016, për pezullimin e prokurorit nga detyra; 5) kërkesë për marrje aktesh drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, datë 30.01.2019; 6) kërkesë për marrje dosje drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, datë 31.01.2019; 7) kopje rekursi drejtuar Gjykatës së Lartë, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; 8) raport mjekësor nr. {***}, datë 28.01.2019; 9) rekomandim për te specialisti; 10) përgjigje rekomandimi; 11) relacion për procedimin disiplinor nga A. D.; 12) mendim për procedimin disiplinor nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; 13) njoftim për shkarkimin nga detyra të Gjovalin Përnoca; 14) shkresa nr. {***} prot., datë 21.02.2013, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë – dërgohet vendimi i mosfillimit të prokurore A. S.; 15) vendim mosfillimi i prokurores A. S., datë 26.09.2012; 16) shkresa nr. {***} prot., datë 15.07.2013, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë – dërgohet vendimi i mosfillimit të prokurore A. S.; 17) vendimi i mosfillimit të prokurorisë A. S., datë 21.01.2013; 18) vendimi nr. 161, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbarimin e mandatit të Gentian Osmanit; 19) njoftim vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shkarkimin e prokurorit Gentian Osmani; 20) vendimi nr. 144 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbarimin e mandatit të Frederik Laloshit; 21) procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, datë 21.01.2019, për Tom Dedajn etj.; 22) procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, datë 17.07.2017, për Majlinda Andrian; 23) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për Ened Nakuçin; 24) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për Shkëlzen Cenani; 25) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për Artan Bajramin; 26) vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për Gurali Brahimllarin; 27) vendimi i kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Erion Roshi, për pranimin e kërkesës për heqje dorë të S. Gj.; 28) kërkesë e gjyqtarës S. Gj. për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes; 29) dokument mjekësor, datë 09.07.2019, për V.; 30) dokument mjekësor i mjekut psikolog I. M.; 31) vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shkarkimin e Altina Xhoxhaj; 32) vendimi i Gjykatës Kushtetuese për proces të parregullt gjyqësor; 33) vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shkarkimin e Antoneta Sevdarit; 34) vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për mbarimin e mandatit për Antoneta Sevdarin; 35) ankimi i Komisionit Publik për Manjola Kajanën.

dijeni për sjelljen dhe vendimet e dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Po aty, z. Dedaj parashtron edhe që Gjykata e Lartë më datë 26.06.2020, me vendimin nr. 00-2020-147², ka marrë një vendim që përbën “një tjetër variant të kundërligjshëm”. Kërkuesi parashtron se, duke mos qenë dakord me sjelljen dhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i detyruar, ka paraqitur kërkesë për gjykim, duke bërë me dije se procesi i gjykimit për ankimin e tij ka filluar më datë 19.02.2019. Kërkesës i është bashkëlidhur vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe kërkesa për marrjen e akteve nga Gjykata Administrative e Apelit.

8. Pas regjistrimit të kërkesës objekt gjykimi [datë 26.02.2021], kërkuesi paraqiti pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit tetë (8) akte të titulluara “prova”³, [të protokolluara me nr. {***} prot., datë 24.03.2021], të cilat nuk gjenden të cituara në kërkesëpadinë e paraqitur më datë 21.10.2020, por as në kërkesat e protokolluara më datë 10.02.2021 dhe 26.02.2021.

III. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

9. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak (në vijim “Kolegji”) sjell në vëmendje se nga leximi harmonik i dispozitave që rregullojnë veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në kuadër të juridiksionit disiplinor, e konkretisht neni 179, pika 7, rezulton së pari se [...] Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë [...] ⁴. Ky parashikim kushtetues është detajuar më tej në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), sipas të cilit:

[...] 3. Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: [...] b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

² Në vendimin në fjalë, Gjykata e Lartë ka vendosur: i) përcaktimin e Gjykatës së Apelit Administrativ si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve nr. 6, 7 dhe 8 të kërkesëpadisë; ii) përcaktimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërtimeve 4 dhe 5 të kërkesëpadisë; dhe iii) prishjen e vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me pjesën e konstatimit të mungesës së kompetencës funksionale për gjykimin e pikës 1, 2, 3 dhe 9 të padisë dhe pushimin e gjykimit të çështjes për këto kërtime të padisë.

³ Aktet bashkëlidhur janë: i) vendimi i datës 19.06.2020 për pushimin e ekzekutimit të urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal për shkak të amnistisë (bazuar në ligjin nr. 5/2020, datë 30.01.2020); ii) shkresa për raportin e vlerësimit të lëshuar nga Zyra Vendore Tiranë e Shërbimit të Provës nr. {***} prot., datë 11.06.2020; iii) vendimi për arkivimin e dosjes së të dënuarit Tom Dedaj, i miratuar nga drejtori i Zyrës Vendore Tiranë të Shërbimit të Provës (për shkak të përfitimit nga ligji për amnistinë); iv) shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***} prot. (Z.H.), datë 23.06.2020, për dërgimin e vendimit të prokurorit për pushimin e ekzekutimit të urdhrin Zyrës Vendore Tiranë të Shërbimit të Provës; v) fleta e parë e rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nr. {***}, datë 06.11.2018, depozituar më datë 20.12.2018; vi) akt i titulluar “rekurs shtesë”, datë 18.02.2019; akt i titulluar “rekurs”, datë 14.11.2018; vii) akt i titulluar “rekurs shtesë”, drejtuar Gjykatës së Lartë që mban datën 21.12.2018, me objekt “Kundër vendimit nr. {***}, datë 06.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda”; si dhe viii) vendimi nr. 633, datë 10.12.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁴ Sipas ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016.

10. Së dyti, bazuar në parashikimet e sipërcituara, sikurse edhe në parashikimet e nenit 148/d të Kushtetutës dhe në dispozitat ligjore të ligjit nr. 96/2016 – nenet 105 dhe 111 – dhe në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 115/2016”) – neni 192, pika 1 – vendimi për shkarkimin nga detyra për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi përbën një nga masat disiplinore që këshillat – në rastin konkret Këshilli i Lartë i Prokurorisë – japin ndaj një prokurori. Konkretisht, dispozitat e përmendura përcaktojnë saktësisht se:

Neni 148/d i Kushtetutës⁵ – 2. *Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur: [...] b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. 3. Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese [...].*

Neni 105 i ligjit nr. 96/2016 – 1. *Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore [...] dh) shkarkim nga detyra [...].*

Neni 111 i po këtij ligji – 1. *Shkarkimi i magjistratit nga detyra jepet si masë disiplinore vetëm në këto raste [...] b) [...], për shkak të dënimit për kryerjen e një krimi [...].*

Neni 192 i ligjit nr. 115/2016 – 1. *[...] Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese [...].*

11. Së treti, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit vepron nën kornizën ligjore të Gjykatës Kushtetuese, si një nga dy kolegjet e kësaj gjykate. Për rrjedhojë, procedura për vlerësimin e kërkesës së kërkuesit dhe shqyrtimi i saj do të bëhet bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”).
12. Për sa i përket anës formale – në këndvështrim të *ratione materiae* – Kolegji konstaton se kërkuesi nuk ka depozituar *ankim* pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Përkundrazi, në tërësinë e akteve dhe kërkimeve të depozituara në data të ndryshme në periudhën kohore nga tetori 2020 – shkurt 2021, asnjë nuk rezulton të jetë konsideruar prej kërkuesit si ankim, në zbatim të së drejtës së garantuar nga neni 148/d, pika 3 e Kushtetutës, e lidhur në mënyrë direkte me objektin e kërkesës – vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 22, datë 28.01.2019, marrë në zbatim të nenit 148/d, pika 2, germa “b” e Kushtetutës – si dhe në zbatim të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës dhe nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 apo edhe në referim të vendimeve të dhëna fillimisht nga Gjykata Administrative e Apelit [datë 22.10.2019] e më pas nga Gjykata e Lartë [datë 26.06.2020], duke i cilësuar këto vendime të kundërligjshme [shkurt 2021].
13. Në përmbledhje, në kushtet kur kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për një masë disiplinore të shkarkimit mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, kërkimi i z. Dedaj për shfuqizimin e vendimit në fjalë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sjell si rrjedhojë që Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit.

⁵ Sipas ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 76/2016.

14. Në analizë të kriterëve të shqyrtimit paraprak, Kolegji mbështetet në përcaktimet e nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000⁶. Po ashtu, meqenëse kërkesa rezulton e paraqitur nga vetë z. Dedaj – ndaj të cilit Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur dhënien e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra – kërkuesi legjitimohet *ratione personae*. Kolegji vëren se pjesa hyrëse e kërkesës, regjistruar fillimisht në datën 21.10.2020 [palët, objekti dhe baza ligjore] është ripërsëritur në kërkesën e regjistruar më datë 26.02.2021. Së dyti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra bazuar në vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, datë 06.11.2018, nr. {***}. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit objekt ankimi që ka vendosur shkarkimin e kërkuesit [nr. 22, datë 28.01.2019], rezulton se deri në datën 31.10.2016 – data e urdhrit [nr. {***}] të Prokurorit të Përgjithshëm që ka vendosur pezullimin nga ushtrimi i detyrës – z. Dedaj ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Kërkuesi ka kërkuar, ndër të tjera, *deklarimin e paligjshëm dhe shfuqizimin e vendimit nr. 22, datë 28.01.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e tij nga detyra* (kërkimi i parë), shoqëruar edhe me 8 kërkime të tjera, nga të cilat të paktën 3 prej tyre lidhen me kërkimin e të drejtave/interesave të pretenduara të cenuara si pasojë e kësaj vendimmarrjeje.
15. Në lidhje me legjitimitimin në kohë, *ratione temporis*, konstatohet se kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit fillimisht me kërkesën e protokolluar në datën 21.10.2020, duke shtuar, përpos 9 kërkimeve të paraqitura edhe më herët pranë Gjykatës Administrative të Apelit, edhe *deklarimin e paligjshëm të vendimit nr. 22, datë 28.01.2019* – togfjalëshi i vetëm që përbën ndryshim. Duke filluar nga kjo datë e deri më datë 26.02.2021, kur është regjistruar kërkesa objekt i këtij gjykimi (përreth 4 muaj), Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shkëmbyer korrespondencë të vazhdueshme me kërkuesin kryesisht për të sjellë në vëmendje të tij kërkesat e nenit 27, pikat 2, germat “dh” dhe “e” dhe 5 të ligjit nr. 8577/2000⁷, për *plotësim të dokumentacionit*. Nga dokumentacioni i administruar, duke ndjekur kronologjikisht komunikimet mes Kolegjit të Posaçëm të Apelit [Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun] dhe kërkuesit, konstatohet se ky i fundit është bërë dy herë me dije – datë 09.11.2020 dhe datë 09.12.2020 – se *nuk* ka plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave ligjore e, për rrjedhojë, kërkesat e tij arkivohen.
16. Kolegji konstaton se kërkesa për gjykim është regjistruar më datë 26.02.2021, pra mbi 2 vite nga dhënia e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Duke aplikuar çdo mënyrë garantiste për të vlerësuar kohën e paraqitjes së kërkesës dhe duke abstraguuar nga forma dhe mangësitë e evidentuara në kërkesëpadinë e protokolluar më datë 21.10.2020 – të bëra me dije qartësisht dhe në më shumë se një rast edhe kërkuesit – nëse merret në konsideratë kjo datë, kërkesa rezulton të jetë paraqitur mbi 20 muaj nga dhënia e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë [28.01.2019]. Po kështu, kjo kërkesë rezulton e paraqitur në një hark kohor afërisht 1 vit pasi Gjykata Administrative e Apelit [22.10.2019], pranë së cilës kërkuesi paraqiti padinë për të zgjidhur kërkesat e tij, dha vendimin që një

⁶ “Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori [...]”.

⁷ “[...] 2. Kërkesa paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim dhe duhet të përmbajë:[...] dh) dokumentet, provat, apo materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën; e) kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkesë, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore [...]. 5. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuesin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuesi nuk e paraqet kërkesën të plotësuar ose brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet [...]”.

pjesë e këtyre kërkimeve duhet të paraqiten pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Edhe duke abstraguuar nga gjithë këto elemente kohore me rëndësi, Kolegji thekson se pjesa e kërkimeve të z. Dedaj që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, objekt kërkimi, nuk ka qenë objekt kontestimi apo interpretimi mbi kompetencën në asnjë shqyrtim nga gjykatat e juridiksionit gjyqësor⁸, të ndodhur në përgjigje të kërkesëpadisë të kërkuesit, gjatë harkut kohor nga 19.02.2019, datë kur kërkuesi pretendon se ka nisur procesin e gjyqimit në gjykatat e juridiksionit gjyqësor. Përpos kësaj, togjalëshi i shtuar në kërkimin e parë – *për deklarin e paligjshëm të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë* – paraqitet për herë të parë para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit më datë 21.10.2020 e në vazhdim edhe në kërkesën e regjistruar më datë 26.02.2021. Siç shtjellohet edhe më poshtë, kërkuesi ka zgjedhur të mos ndjekë çështjen në përputhje me nenin 148/d të Kushtetutës dhe zgjodhi të mos paraqitej në Kolegji edhe kur iu dha mundësia më herët në gjykimin e vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative e Apelit.

17. Përpara depozitimit të kërkesës së datës 21.10.2020, kërkuesi është njoftuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit – fillimisht në datën 07.02.2020 – për gjykimin në seancë plenare publike të kërkesës kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë objekt shqyrtimi, vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative e Apelit më datë 19.12.2019. Ky njoftim është përsëritur sërish në datën 19.06.2020⁹. Sikurse rezultoi edhe nga vendimi i dhënë nga Kolegji më datë 20.07.2020, megjithëse kishte dijeni për shqyrtimin e kësaj çështjeje në Kolegji dhe për zhvillimin e procesit, z. Tom Dedaj zgjodhi të mos paraqesë kërkesa apo parashtrime me shkrim në lidhje me objektin e gjyqimit dhe pretendimet e tij, si dhe të mos ishte i pranishëm në seancën plenare publike. Së fundmi, rezultoi se Gjykata e Lartë e ka mbyllur shqyrtimin gjyqësor më datë 26.06.2020, duke e pushuar gjykimin për këto kërkime rreth 24 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës plenare publike në Kolegji, çka teorikisht duhet t'i jepte mundësinë kërkuesit të ishte i qartë në kërkesën e tij për të kundërshtuar vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë që vendosi shkarkimin e tij.
18. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji, bazuar në përcaktimet e nenit 71/a, pika 1, germa “b”, e analizuar në harmoni me parashikimet e nenit 31/a, pika 2, germa “ç” e ligjit nr. 8577/2000, vlerëson se kërkuesi ka paraqitur kërkesën me kërkimet e cituara në objektin e këtij vendimi përtej afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Konkretisht, këto dy dispozita ligjore përcaktojnë shprehimisht se:

1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur: [...] b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit [...].

[...] 2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur: [...] ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor [...].

19. Në përfundim, në kushtet kur kërkesa është paraqitur përtej afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit të interesave, bazuar në parashikimet e nenit 71/a, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8577/2000 dhe në zbatim të

⁸ Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit të datës 22.10.2019, vendimi i së njëjtës gjykatë më datë 17.12.2019, me anën e të cilit nuk është pranuar rekursi i z. Dedaj kundër vendimit për mungesë kompetence, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë i datës 09.03.2020, apo eventualisht vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 26.06.2020, vënë në lëvizje nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

⁹ Paragrafët 22 dhe 24 të vendimit nr. 1/2020 (JD), datë 20.07.2020 – <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendimi-Tom-Dedaj-i-anonimizuar-.pdf>.

dispozitave të nenit 31/a, pika 2, germa “ç” e po këtij ligji, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “ç”, si dhe nenin 71/a, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 06.05.2021.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi